

KOMUNIKIMI INXHINIERIK

Kodi i lëndës	Semestri	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Detyra	
B-ELN-112	I	2.5	1	-	0.5	4
Sasia e orëve: auditor/ jashtë auditorit		30/32.5	14/11	-	2.5/10	46.5/53.5
Sasia e orëve: Total		62.5	25	-	12.5	100

Titullari i lëndës: Aleksander Biberaj, Profesor i Asocuar

Lënda është e tipit të formimit për aftësi komunikimi.

Njohuri paraprake

Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë të komunikimit gjatë studimeve parauniversitare. Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë mbi konceptin e prezentimit.

Objektivat e lëndës

Kursi i jep studentit një kulturë bazë në gjuhën e shkruar, si dhe formatet kryesore të komunikimit dhe shkrimit teknik, në mënyrë që studentët të përmirësojnë aftësitë e tyre të komunikimit, nëpërmjet paraqitjes së materialeve të shkruara, ose paraqitjeve me gojë në fushat inxhinierike.

Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i lëndës

Lënda zhvillohet në semestrin e dytë, në vitin e parë, në 14 javë. Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë: të fitojë aftësi komunikuese, të njohë strukturën e UPT, FTI, programet e studimit, të njohë elemente të komunikimit me postën elektronike (e-mail), të fitojë aftësi për shtrimin e problemeve, të jetë i aftë të punojë në grup, të zgjidhë problemet e grupit, të jetë i aftë të prezantojë ide dhe t'i parashtojë ato në mënyrë të suksesshme.

Literatura e rekomanduar për lëndën

Aleksander Biberaj, *Komunikimi Inxhinierik (konspekt-leksionesh)*; 2017.

Sunita Mishra C.Muralikrishna, *Communication Skills for Eng.*; 2007, Pearson Education, 2nd Edition (June 1, 2011); ISBN-10: 813173384X; ISBN-13: 978-8131733844